



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL LEZHË

Nr. _____ Prot.

Data: 03.09.2025

PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Evadim, Trajtim dhe Asgjësim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore në Spitalin Rajonal Lezhë”, e ndarë në 3 (tre) lote - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

“Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore”: 90524400-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,085,000.00 (gjashtë milion e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH dhe sipas loteve:

Nr. Lotit	Kodi	Llojet e mbetjeve spitalore te rrezikshme	Njesia	Fondi Limit
1	18 01 01	Loti 1: Te mprehtat - Instrumente të mprehta të përdorura si age, bisturite, shiringa, brisqe, instrumente të mprehta, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme (përveç 18 01 03)	Kg	800,000.00
2	18 01 02	Loti 2: Anatomiket - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut, (përveç 18 01 03) sende të ndotura me gjak serume dhe plazme, mbetje të mjekimeve dhe vaksinave, mbetje izolimi nga pacientë me koeficientë infektimi të lartë.	Kg	885,000.00

3	18 01 03	Loti 3: Infektive - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi I të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet	Kg	4,400,000.00
---	----------	---	----	--------------

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, VKM nr. 178, datë 6.3.2012, “Për incinerimin e mbetjeve” i ndryshuar, VKM nr. 452, datë 11.7.2012, “Për lëndfillet e mbetjeve”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’” i ndryshuar, Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore, VKM nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, VKM nr. 371, datë 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, VKM nr. 418, datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, VKM Nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020 –2035”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, autoriteti kontraktor **“Drejtoria e Spitalit Rajonal Lezhe”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 82 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-ja Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, pika 1, neni 26.

Pika 1 Neni 82 e këtij ligji parashikon se:

“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Shuma e sigurimit të ofertës është: 121,700.00 (njqind e njezete e nje mije e shtateqind) leke

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Kodi	Llojet e mbetjeve spitalore te rrezikshme	Sigurimi i ofertes
18 01 01	Loti 1: Te mprehtat - Instrumente të mprehta të përdorura si age, bisturite, shiringa, brisqe, instrumente të mprehta, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme (përveç 18 01 03)	16,000.00
18 01 02	Loti 2: Anatomiket - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut, (përveç 18 01 03) sende të ndotura me gjak serume dhe plazme, mbetje të mjekimeve dhe vaksinave, mbetje izolimi nga pacientë me koeficientë infektimi të lartë.	17,700.00
18 01 03	Loti 3: Infektive - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi I të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet	88,000.00

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kriter 2.1.1 Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe në Termat e Referencës së DST (PËRVEC INCENERIMIT), ose teknologji ekuivalente,

Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

1.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës,

si dhe

1.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë:

Kodi	Llojet e mbetjeve spitalore te rrezikshme
18 01 01	Loti 1: Te mprehtat - Instrumente të mprehta të përdorura si age, bisturite, shiringa, brisqe, instrumente të mprehta, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme (përveç 18 01 03)
18 01 03	Loti 3: Infektive - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi I të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet

Kriter 2.1.2 Për metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

- 2.a** Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe
2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

Kodi	Llojet e mbetjeve spitalore te rrezikshme
18 01 02	Loti 2: Anatomiket - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut, (përveç 18 01 03) sende të ndotura me gjak serume dhe plazme, mbetje të mjekimeve dhe vaksinave, mbetje izolimi nga pacientë me koeficientë infektimi të lartë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të pikës 5 Menaxhimi i Mbetjeve të Shtojcës 1 Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi të Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr. 798, date 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores, Për administrimin e mbetjeve spitalore”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, Udhëzuesi Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Ligjit Nr. 10081, date 23.02.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 538 date 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar.

Kriter 2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha Çertifikatat si me poshtë vijon:

- 3.a** ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilesisë) ose ekuivalent;
3.b ISO 14001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent;
3.c ISO 45001:2018 (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punetoreve në punë) ose ekuivalent.

Certifikatat duhet të jenë të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe brenda afatit të vlefshmerisë.

Argumentimi: 1. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, nenit 41, pika 4/a dhe nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita, Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Këto kriteret gjejnë mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

- ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime më të ulta.
- ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i

sherbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i sherbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjes me sukses të kontratës së sherbimit objekt prokurimi.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara , është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

Kriter 2.1.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese Akt Miratimin Higjeno –Sanitar respektiv per objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror).

Argumentimi: Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 7643 datë 12.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar" i ndryshuar, dhe në nenin 10.3 të Kreut IV "Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjeno – Sanitar" të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore", ku parashikohet: "10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjiëno-shëndetësor, lëshon akt-miratim higjiëno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë".

Kriter 2.1.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese vërtetimin që ka dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, raportet e vetmonitorimeve periodike, në zbatim të kushteve të Lejes Mjedisore që disponon, sipas Ligjit "Për Lejet e Mjedisit" Nr.10448 date 14.07.2011, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar.

Kriter 2.1.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese vërtetimin që ka kryer pagesen per tarifën vjetore të Lejes Mjedisore, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të VKM nr. 417, date 25.06.2014, "Për Miratimin e Tarifave të lejeve të Mjedisit".

Kriter 2.1.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese vërtetimin që nuk ka masë administrative në fuqi nga strukturat inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të Ligj Nr.10433 date 16.06.2011 "Per Inspektimin ne Republiken e Shqiperise", Ligjit "Për Lejet e Mjedisit" Nr.10448 date 14.07.2011 si dhe Ligji Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE".

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 41, pika 4/a dhe nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kriter 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të

jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit apo shumës së loteve për te cilat oferton sipas tabelës së mëposhtme.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e xhiros vjetore për secilin Lot nuk duhet të jetë më e vogël se:

Kodi	Llojet e mbetjeve spitalore të rrezikshme	Vlera e xhiros vjetore
18 01 01	Loti 1: Te mprehtat - Instrumente të mprehta të përdorura si age, bisturite, shiringa, brisqe, instrumente të mprehta, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme (përveç 18 01 03)	160,000.00
18 01 02	Loti 2: Anatomiket - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut, (përveç 18 01 03) sende të ndotura me gjak serume dhe plazme, mbetje të mjekimeve dhe vaksinave, mbetje izolimi nga pacientë me koeficientë infektimi të lartë.	177,000.00
18 01 03	Loti 3: Infektive - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi I të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet	880,000.00

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në piken 1 dhe piken 2/c të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar, ku përcaktohet se: **Pika 1.** Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. **Pika 2/a:** 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence". Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara me poshte, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Neni 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur. AK është e vetmja qendër terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e prokurimit Publik në tërësi.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' e ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Si rrjedhim Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës për secilin lot, nuk do të jete më e vogël se:

Kodi	Llojet e mbetjeve spitalore te rrezikshme	Vlera e furnizimeve te meparshme
18 01 01	Loti 1: Te mprehtat - Instrumente të mprehta të përdorura si age, bisturite, shiringa, brisqe, instrumente të mprehta, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme (përveç 18 01 03)	160,000.00
18 01 02	Loti 2: Anatomiket - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut, (përveç 18 01 03) sende të ndotura me gjak serume dhe plazme, mbetje të mjekimeve dhe vaksinave, mbetje izolimi nga pacientë me koeficientë infektimi të lartë.	177,000.00
18 01 03	Loti 3: Infektive - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi I të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet	880,000.00

Kur konkurohet për më shumë se 1 (nje) lot, 20% do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 3 te nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" e ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Si rrjedhim, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve", pika 3 (ose në rastin e procedurave të

thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

AK argumenton se për **shërbime** të mëparshme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 2.3.1, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e **shërbime** të mëparshme të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Kriteri 2.3.2 Operatori duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, apo nepermjet cdo menyre posedimi të njohur nga ligji, minimalisht **1(nje) automjet** që transporton mbetjet spitalore, sipas kërkesave të Nenit 23 të Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”i ndryshuar, si dhe Shtojcës 4 të VKM Nr.798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja) si dhe në zbatim të Pikës 9.3.3 (**Automjetet**/anijet e grumbullimit) të Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”, sipas kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës të ketyre DST. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

➤ **Për automjet në pronësi:**

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Leje qarkullimi,
- Akt - kolaudimi
- Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjenosanitare,
- Foto të mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.

➤ **Për automjetet që nuk janë në pronësi:**

- Kontratë qiraje ose huapërdorje brenda afatit të vlefshmerise të shoqeruar me aktin e pronesise se qiradhenesit/pronarit.
- Leje qarkullimi e mjetit;
- Akt kolaudimi;
- Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet
- Fotot e mjeteve dhe Akt – Miratimet Higjenosanitare.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e të dhënave të mjeteve nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST.**

Shënim*: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26 të VKM nr 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”,**

“i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 4/ç e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Duke marrë në konsideratë faktin se shërbimi objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK në ambientet e trajtimit të operatorit ekonomik, si dhe te produkti final nga ambientet e operatorit drejt landfillit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën me qëllim ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Perlllogaritja e numrit minimal te automjeteve te kerkuara eshte bere duke marre parasysh fillimisht, qe automjetet qe do të përdoren për këtë lloj shërbimi do të jenë të llojit furgona qe nuk e kalojnë peshen totale me gjithë ngarkesë 3.500 kg, pasi keto kategori automjetej jane te manovrueshme për të qarkulluar në ambientet spitalore. Kapaciteti i zakonshëm i këtyre lloj automjetej varion nga 500 kg deri në 1.300 kg.

Përlllogaritja merr ne konsiderate faktin qe frekuenca e kerkuar e terheqjes eshte javore dhe qe OE realizon sherbime edhe ne kliente te tjere te shperndare ne territor dhe qe ne disa raste volumi javor i grumbulluar nga AK mund ta kaloje kapacitetin e vetem nje automjeti, si dhe nevojat per sherbime qe ka herepashere cdo automjet.

Nga sa me siper nevojiten minimalisht **1 Automjete** per te kryer sherbimin objekt te Marreveshjes Kuader.

Kriteri 2.3.3 Operatori/et ekonomik pjesemarres per te realizuar sherbimin objekt prokurimi, duhet te kete minimalisht te punësuar **5 persona:** 1 (nje) shofer dhe 4 (kater) punonjës mbështetës për ngarkimin/shkarkimin dhe përpunimin e mbetjeve.

Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë: **deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:**

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes
----	--------------	------------	---

Shënim 2.1 : Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe diplomat/certifikatat e cdo punonjesi prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

Shënim 2.2: Me qellim garantimin e gjithë perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shenim: Ky kriter ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik do te konsiderohet i permbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 10 te DST. Ne rastet kur OE do te shpallet fitues duhet te paraqese dokumentacionin provues sipas ketij kriteri.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe me germen b dhe c pika 4 të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Ky kriter është plotësuar në bazë të volumit të shërbimeve sipas zerave të shërbimeve, të percaktuara në preventivin e shërbimeve, specialistët e mësipërm, janë përcaktuar në përputhje me listën e shërbimeve. Pra janë vendosur kërkesa të cilat lidhen ngushtë aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Dëshmia profesionale dhe dëshmia kualifikimit teknik, janë kërkuar nga AK për t'u siguruar në aftësitë e specialistëve për zbatimin korrekt të shërbimeve si dhe që këta specialistë kanë njohuritë e duhura për rregullat e sigurimit teknik në punë.

Kriteri 2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë në **personelin kryesor, minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedi**si të specializuar/të kualifikuar.

Për Inxhinierin e mjedisit të paraqitet:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Inxhinier Mjedi
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune.
- Duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në këtë profesion. Të paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqerore individuale e lëshuar nga e - Albania.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e emrit të Inxhinierit nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST.**

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit që ka specialitetin perkates ne lidhje me "Kërkesat për kualifikim", në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar. Ky kriter gjën mbështetje në VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar të nenit 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve", piken 4, ku percaktohet se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) **një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose**
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur Kontratën.

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij Inxhinier Mjedisi është vendosur në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit lidhur me Tajtimin dhe Evadimin e Mbetjeve Spitalore bazuar në specifikat e këtij shërbimi.

Kriteri 2.3.5 Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, apo nepermjet cdo menyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant primar për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1
- b. Impiant primar për asgjësimin me incenerim - cope 1
- c. Makineri për larjen e kontenierëve - cope 1

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht **makineria** për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te ripërdorshëm duhet të jenë të pajisur me;
 - a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjësimin me incenerim
 - a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente) ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
 - b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerise;
 - c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

*Shënim nr. 1: AK rezervon të drejtën, që përpara Njoftimit të Fituesit Përfundimtar të kryejë verifikime në instalimet e OE-ve të kualifikuar në SPE.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e të dhënave për secilen pajisje nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”,

VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, impiantet për realizimin e trajtimit të kategorive të caktuara të mbetjeve spitalore, janë pajisjet baze për realizimin me sukses të këtij shërbimi. Gjithashtu, AK, në planifikimin e menaxhimit të mbetjeve spitalore, ka parashikuar që në dallim nga kontenitorët për të mprehtat dhe qeset, që janë amballazhi i drejtpërdrejtë i mbetjeve spitalore që duhet të jenë njëpërdorimëshe, kontenitorët plastikë të medhenj që duhet të vihen në dispozicion nga Operatori Ekonomik fitues që shërbejnë për transferimin dhe transportin e mbetjeve spitalore, duhet të jenë shumëpërdorimësh dhe kjo nuk është një zgjedhje subjektive e AK, por e ndikuar nga shkaqet ligjore, ekonomike dhe mjedisore sic përcaktohet nga neni 6 i Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, neni 7 dhe neni 33 i Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe në Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”. Pra, AK në planifikimin e menaxhimit të mbetjeve spitalore, duke kërkuar konteniere plastikë të mëdhenj që mund të ripërdoren, ka zbatuar pikërisht parimin e “minimizimit të prodhimit të mbetjeve”, pasi nëse do të pranonte vetëm konteniere njëpërdorimësh që duhet të asgjësohen pas çdo përdorimi së bashku me mbetjet spitalore, do të shumëfishonte volumin e mbetjeve që shkojnë për asgjësim dhe kjo do të ishte në kundërshtim me të gjitha parimet e sipërcituara. Për këtë arsye, për kontenierët e medhenj që janë shumëpërdorimësh është e nevojshme të garantohet që OE disponon pajisjet dhe lejet e nevojshme për larjen dhe higjienizimin e tyre me qëllim ripërdorimi.

Lejet e kërkuara për objektin/et e dhene/a me qera vertetojnë se këto pajisje janë të licensuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky certifikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e tretë ndaj kërkesës është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë. Fokusi i kësaj kërkesë është tek impianti dhe jo tek personat e tretë të cilët japin me qera apo huapërdorje.

Ky shërbim do të jetë i vazhdueshëm dhe me dinamika të ndryshme sasiore. Kërkesat për marrjen e mbetjeve javore nuk mund të përcaktohen paraprakisht pasi nuk mund të parashikohen gjenerimet sasiore çka do të bente një kalendar të saktë për OE. Afatet kohore për grumbullimin e mbetjeve janë taksative nga pikepamja ligjore dhe të ndryshme sa i takon rrymave të tyre. Rrjedhimisht kjo gjë kërkon me patjetër nga OE grumbullimin e mbetjeve sipas kërkesave të AK në kohë të ndryshme çka e bën këtë shërbim të vazhdueshëm dhe të paparashikueshëm.

Kriteri 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

- Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi brenda afatit të vlefshmerisë,

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, si dhe duke qene se ne baze te VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, strukturat spitalore si krijues të mbetjeve jane pergjegjes deri ne hallken e fundit te asgjesimit te mbetjeve spitalore qe krijojnë, AK kerkon qe operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me subjekt te autorizuar sipas ligjit per depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjesimit, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Keto dokumente kerkohen me qellim realizimin me sukses te asgjesimit final te mbetjeve si element mjaft i rendesishem i procesit ku dokumentohet qe OE eshte ne kete fushe aktiviteti dhe e kryen realisht kete lloj sherbimi. Duke patur parasysh abuzimet e ndryshme te cilat i behen ketij procesi, ky kriter eshte mëse i domosdoshem dhe gjithashtu do te kerkohet ne vazhdimesi si pjese e monitorimit te zbatimit te kontrates.

Kriteri 2.3.7 Operatori duhet te furnizojë kontenitorët sipas standarteve dhe kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të References. Per te provuar plotesimin e ketij kriteri operatori duhet te paraqese per **secilin lloj kontenitori**:

- Katalog ose skede teknike,
- Certifikaten e aprovimit te tipit te ambalazhit per secilin lloj kontenitori (i riperdorshem ose njeperdorimesh) referuar VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 4/ç nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, kontenitorët e mbetjeve spitalore jane elemente te domosdoshem ne proceset e menaxhimit te evadimit te mbetjeve spitalore si per mbledhjen, izolimin, grumbullimin, dhe transportimin e tyre.

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, te nenit 26, te VKM nr 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”,

“h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 10 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit si dhe rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet që do të paraqiten nga operatorët ekonomik.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 6.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

A. Specifikimi i materialeve

Mbetje KODI 18 01 01 (Instrumente të mprehta (përveç 18 01 03) Instrumenta të mprehta të përdorur, si për shembull age,shiringa, bisturi, brisqe, pajisje të përziera, qelqe të thyer dhe të ndotur, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme).

Mbetje KODI 18 01 02 (Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03), produktet e gjakut; sende të ndotura me gjak serume dhe plazëm; kultura dhe grumbullime të agjentëve infektues që krijohen nga laboratorë kërkimore dhe diagnostikimi dhe materiale të ndotura me agjentë të tillë; mbetje izolimi nga pacientë me koeficient infektimi të lartë; mbetje të mjekimeve dhe të vaksinave; mbetje, shtresa dhe materiale të tjera të infektuara me patogjenë trupore.),

Mbetje KODI 18 01 03 (mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të vecantë për të parandaluar infeksionet),

B. Pershkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Asgjësimi duhet të realizohet nga OE me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM nr.798 datë 29.09.2010 “Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”.

2. AK, do të vëre në dispozicion të OE, një ambient të përshtatshëm brenda Spitalit Rajonal Lezhe për të vendosur frigorifer ose cdo pajisje tjetër, të nevojshme, ashtu siç kërkon kuadri rregullator ligjor, për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore në RSH. Pajisjet e vendosura nga OE, duhet të kenë një kapacitet që të sigurojnë grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore në masën më 200 kg.

Pas marrjes në dorezim të ambienteve të depozitimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore, OE, është përgjegjës për të bërë dezinfektimin e ambientit sipas kuadrit rregullator ligjor në RSH.

C. Terheqja e mbetjeve nga vendgrumbullimi dhe transportin deri në vend trajtim

Operatori ekonomik duhet të sigurojë grumbullimin e kontenierëve me mbetje në pikat e perkohshme të magazinimit të autoriteteve shëndetësore si dhe transportin e tyre në impiantin e trajtimit me mjetet e posacme të transportit.

Njekohesisht me grumbullimin e kontenierëve duhet të vihen në dispozicion konteniere të rinj të gatshëm për tu përdorur.

AK, i dorezon përfaqësuesit të autorizuar të OE, me proces-verbal, mbetjet e rrezikshme spitalore. Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet spitalore, do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të OE dhe përfaqësuesit të AK, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutitë e ambalazhimit (peshë e tyre zbritet). Shpenzimet e ambalazhimit (kontenieret, kutitë, qeset, etj.) do të mbulohen nga OE.

Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshorë e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë që do të vihet në dispozicion nga OE (OE të paraqes certifikatën e kolaudimit të peshorës).

Përfaqësuesi i OE, në prani të komisionit të AK, kryhen marrjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore, me automjet dhe ben transportimin e tyre për në vendin e trajtimit të tyre.

Automjetet e OE, të jenë lehtësisht të identifikueshme gjatë transportit të mbetjeve të rrezikshme spitalore, me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjeve të rrezikshme spitalore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr.4 të VKM nr.798 datë 29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhezuesin Kombëtar “Administrimi i sigurtë i mbetjeve të rrezikshme spitalore”.

Nga të pranishmit të AK dhe OE, mbahet proces-verbal për këtë qëllim.

Transporti i kontenierëve duhet të kryhet në mënyrë që të sigurohet integriteti dhe pastërtia e tyre, në përputhje me rregullat e higjenes dhe sigurisë.

Automjetet e përdorura për transportin e mbetjeve spitalore duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

Çdo automjet që transporton mbetje spitalore të rrezikshme:

1. Duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me simbolin dallues ndërkombëtar të rrezikut të mbetjes spitalore që transportohet. Simboli të mos jetë më i vogël se 250 mm X 250 mm.
2. Duhet të ketë një panel paralajmërues, të vendosur dukshëm në anën e përparme dhe të pasme të automjetit për të treguar transportin e mbetjeve spitalore. Paneli paralajmërues i rrezikut (Varianti A ose B më poshtë) të jetë në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit të transportit të mbetjeve spitalore në një pozicion që nuk mbulon asnjë dritë, targën ose shënime apo shenja të tjera të kërkuara ligjërisht. Të dy variantet janë të pranueshme dhe zgjedhja varet kryesisht nga hapësira në dispozicion.

Specifikimet:

- **Materiali:** pjatë alumini (1-2 mm e trashë)
- **Veshja:** sfond reflektues
- **Ngjyrat:** konturi – i zi
sfondi – i verdhë
fjalët – të zeza
- **Përmasat:** fjalët ≥ 40 mm në lartësi
- **pjata (Versioni A):** gjatësia ≥ 200 mm; gjerësia ≥ 750 mm
- **pjata (Versioni B):** gjatësia ≥ 340 mm; gjerësia ≥ 500 mm

Varianti A



Varianti B



3. Të sigurojë kontakt minimal të njeriut me kontenierët

4. e mbetjeve spitalore gjatë ngarkim-shkarkimit të tyre.
5. Të ketë një ndarje midis kabinës së shoferit dhe trupit të automjetit.
6. Të ketë një sistem të përshtatshëm për sigurimin e ngarkesës gjatë transportit.
7. Të mbahet i kyçur përveç kur ngarkohet dhe shkarkohet.
8. Të jetë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet e mbetjeve të ngurta dhe të lëngta

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të realizojë ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve në dhe nga makina e grumbullimit. Personeli i trajnuar dhe caktuar për këto qëllime duhet të përdorë veshje të përshtatshme mbrojtëse si doreza, çizme, përparëse dhe maskat.

Për realizimin e shërbimit për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, bazuar në kërkesat e legjisllacionit në fuqi, operatori ekonomik duhet të sigurojë:

1- Furnizimin me bazen materiale të nevojshme për realizimin e ndarjes në burim dhe magazinimin provizor të mbetjeve spitalore deri në terheqjen e tyre, sipas kërkesave për secilin kod të mbetjeve spitalore.

Për këto qëllime, Operatori Ekonomik duhet të vërë në dispozicion të AK, konteniere plastikë, qese plastike, kuti për të mprehtat, kuti kartoni (njëpërdorimshëm) për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Kompania duhet të realizojë një furnizim të përshtatshëm në çdo kohë me materiale ndihmëse të nevojshme për grumbullimin e perkohshëm të mbetjeve.

I. Materialet ndihmëse duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

Për realizimin e shërbimit për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, bazuar në kërkesat e legjisllacionit në fuqi, operatori ekonomik duhet të sigurojë:

Furnizimin me bazen materiale të nevojshme për realizimin e ndarjes në burim dhe magazinimin provizor të mbetjeve spitalore deri në terheqjen e tyre, sipas kërkesave për secilin kod të mbetjeve spitalore.

Për këto qëllime, Operatori Ekonomik duhet të vërë në dispozicion të AK, konteniere plastikë, qese plastike, kuti për të mprehtat, kuti kartoni (njëpërdorimshëm) për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Kompania duhet te realizoje nje furnizim të përshtatshëm në cdo kohe me materiale ndihmese te nevojshme per grumbullimin e perkohshem te mbetjeve.

Kuti për të mprehtat (brenda diapazonit 3 – 12 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent) “Mbrotjtja nga dëmtimi prej objekteve të mprehta - Kërkesat dhe metodat e testimit - Kontenierët (enët) e objekteve të mprehta”.
- Hapja të jetë aq e gjerë sa të lejojë që mbetjet spitalore të hidhen në kuti duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e mbetjes spitalore për të cilën është projektuar , kutia për të mprehtat, hapja në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në kuti;
- Të jenë të tilla që të mbyllen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e kutive për të mprehtat të mos lejojnë rrjedhje.
- Të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Të jenë me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës; dhe për të mprehtat e ndotura nga citotoksikë, me kapak ngjyrë të kuq ose të purpurt me simbolin e mbetjeve citotoksike;
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. ku të lexohen qartë fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

Koshat plastikë (brenda diapazonit 40 – 60 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent);
- Të tillë që të mbyllen në mënyrë të sigurtë;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe shpimet;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa perkatese sipas pikes II të këtyre Specifikimeve “ETIKETIMI”.

Shënim: Në rastin e koshave plastike shumëpërdorimësh, duhet të garantohet larja dhe dezinfektimi i tyre në makinerinë përkatëse të specializuar

Qeset plastike

Janë qese plastike për grumbullimin dhe ruajtjen e mbetjeve spitalore dhe mbetjet e lidhura me to, përveç mbetjeve të mprehta.

- Të jenë me trashësi jo më të vogël se 70 mikron dhe të kenë rezistencë të mjaftueshme për të mbajtur në mënyrë të sigurt klasën e mbetjeve për të cilat ato janë caktuar;
- Të kenë kapacitet maksimal nominal prej 0.1 m³;
- Të jenë të përmasave dhe formës së përshtatshme për enët mbajtëse me të cilat do të përdoren;
- Të jenë të pajisur me lidhëse për mbyllje të sigurt. Të mos mbyllen me kapse ose me pajisje të tjera mbyllëse me dalje të mprehta.
- Të jenë të tilla që mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet ose që të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa përkatëse.

II. ETIKETIMI

Çdo enë e mbetjeve spitalore duhet të ketë në pjesën e jashtme të saj një etiketë e cila të përmbajë shenjëën ndërkombëtare të Biohazardit sipas modelit me përmasat e specifikuara në më poshtë:

Etiketa të prodhohet me material që u reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjyeshme, ose të jetë e stampuar në një pozicion të dallueshëm të enës që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

PËRMASAT E SIMBOLIT

Tipi i kontenierit të mbetjeve spitalore

Përmasat e simbolit

Për të mprehtat:

- | | |
|--|------------------------------|
| i. me kapacitet prej më pak se 2 litra | jo më pak se 40 mm x 40 mm |
| ii. me kapacitet prej 2 litra ose më shumë | jo më pak se 75 mm x 75 mm |
| iii. të tjerë: | jo më pak se 150 mm x 150 mm |



SIMBOLI NË ETIKETË

Ngjyrat e simbolit të jenë si më poshtë:

Konturet – ngjyrë e zezë

Fusha – ngjyrë e bardhë ose ngjyra parësore e enës

Fjalët dhe karakteret – ngjyrë e zezë

Shenja ndërkombëtare e Biohazardit – ngjyrë e zezë

PËRMBAJTJA E ETIKETËS

Çdo kontenier i mbetjeve spitalore, pasi mbyllet dhe vulozet, të identifikohet me një etiketë që të vendoset në pjesën e përparme të kontenierit dhe që të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- i. Identifikimin: Mbetje Spitalore
- ii. përcaktimin: “Infektuese”
- iii. fjalën sinjalizuese: Rrezik
- iv. njoftimin e rrezikshmërisë: “Mund të shkaktojë infeksion”
- v. Kodin sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve: 18.
- vi. Gjendjen: e ngurtë ose të lëngët;
- vii. Datën e fillimit dhe përfundimit të grumbullimit;
- viii. Sasinë në kg ose litra;
- ix. Prodhuesin / Kodin Unik / Adresën / Personin përgjegjës (Emër/mbiemër/firmë / nr.telefoni

PER ORIENTIM-MODEL ETIKETE:

MBETJE SPITALORE RREZIK! Mund të shkaktojë infeksion RRYMA E MBETJEVE: 18. (sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve) GJENDJA: NGURTE ☐ LËNGSHME ☐ GRUMBULLIMI I MBETJEVE: DATA E FILLIMIT: ... / ... / 20 ... DATA E PËRFUNDIMIT: ... / ... / 20 ... SASIA: (.....) (kg ose l) PRODHUESI: KODI UNIK: ADRESA: PERSONI PËRGJEGJËS: (emër/mbiemër/firmë) Nr. Telefoni:	
--	--

Etiketat për vendin e magazinimit të AK

Kontraktori duhet të sigurojë për AK etiketat që duhet të vendosen dukshëm si shenja e rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, sipas modelit të mëposhtëm:



III. Terheqja e mbetjeve nga vendgrumbullimi dhe transportin deri ne vend trajtim.

Operatori ekonomik duhet te siguroje grumbullimin e konteniereve me mbetje ne pikat e perkohshme te magazinimit te autoriteteve shendetesore si dhe transportin e tyre ne impiantin e trajtimit me mjetet e posacme te transportit.

Njekohesisht me grumbullimin e konteniereve duhet te vihen ne dispozicion konteniere te rinj te gatshem per tu perdorur.

Transporti i konteniereve duhet te kryhet ne menyre qe te sigurohet integriteti dhe pastertia e tyre, ne perputhje me rregullat e higjenes dhe sigurise.

Automjetet e perdorura per transportin e mbetjeve spitalore duhet te kenë karakteristikat e mëposhtme:

Çdo automjet që transporton mbetje spitalore të rrezikshme:


9. Duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me simbolin dallues ndërkombëtar të rrezikut të mbetjes spitalore që transportohet. Simboli të mos jetë më i vogël se 250 mm X 250 mm.
10. Duhet të ketë një panel paralajmërues, të vendosur dukshëm në anën e përparme dhe të pasme të automjetit për të treguar transportin e mbetjeve spitalore. Paneli paralajmërues i rrezikut (Varianti A ose B më poshtë) të jetë në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit të transportit të mbetjeve spitalore në një pozicion që nuk mbulon asnjë dritë, targën ose shënime apo shenja të tjera të kërkuara ligjërisht. Të

dy variantet janë të pranueshme dhe zgjedhja varet kryesisht nga hapësira në dispozicion.


Specifikimet:

- **Materiali:** pjatë alumini (1-2 mm e trashë)
- **Veshja:** sfond reflektues
- **Ngjyrat:** konturi – i zi
sfondi – i verdhë
fjalët – të zeza
- **Përmasat:** fjalët ≥ 40 mm në lartësi
- **pjata (Versioni A):** gjatësia ≥ 200 mm; gjerësia ≥ 750 mm
- **pjata (Versioni B):** gjatësia ≥ 340 mm; gjerësia ≥ 500 mm

Varianti A



Varianti B



11. Të sigurojë kontakt minimal të njeriut me kontenierët e mbetjeve spitalore gjatë ngarkim-shkarkimit të tyre.
12. Të ketë një ndarje midis kabinës së shoferit dhe trupit të automjetit.
13. Të ketë një sistem të përshtatshëm për sigurimin e ngarkesës gjatë transportit.
14. Të mbahet i kyçur përveç kur ngarkohet dhe shkarkohet.
15. Të jetë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet e mbetjeve të ngurta dhe të lëngta

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të realizojë ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve në dhe nga makina e grumbullimit. Personeli i trajnuar dhe caktuar për këto qëllime duhet të përdorë veshje të përshtatshme mbrojtëse si doreza, çizme, përparëse dhe maskat.

IV. Dezinfektimin

Operatori Ekonomik duhet te realizoj densifikimin:

- Të kontenierëve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore duhet të dezinfektohen para dhe pas çdo terheqje.
- Mjediseve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të caktuara nga AK ku realizohet terheqja e kontenierëve, të cilët duhet të dezinfektohen në intervale të rregullta.

V. Trajtimin e mbetjeve spitalore dhe asgjësimin final të produktete të trajtimit, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi

Mbetjet e rrezikshme spitalore, që dorezohen për transport (nga një person fizik apo juridik tek një tjetër), nga ambientet e Spitalit Rajonal Lezhe, për në ambientet e OE, ku bëhet trajtimi i tyre, nga OE, shoqërohen me dokument transferimi nga OE, sa herë që do të bëhet evadimi, transporti, trajtimi i këtyre mbetjeve, dhe një kopje e tij, i dorëzohet komisionit të ndjekjes së zbatimit të kontratës të AK dhe bëhet pjesë e procesverbalit të përbashkët.

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë III 2 B, Leje të Mjedisit të tipit A dhe/ose B sipas kategorisë së mbetjeve dhe Akt-Miratim Higjieno-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- i. termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ii. kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- iii. mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore

- a. *Teknologjitë termike pa djegie*

- i. Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehjes së mbetjeve nga avulli nën presion.
- ii. Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
- iii. Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehur mbeturinat, ndërkohë mbetjet copëtohen në kokrriza të thata.
- iv. Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehen nëpërmjet përcimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.

b. Teknologjitë kimike

- i. Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar.

c. Teknologjitë me djegie

- i. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjegshme dhe që rezulton në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”.

D. Asgjesimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjesim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjesimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive në momentin e dorezimit të ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër do të jete përgjegjës që të mundesoje që ky shërbim të vazhdojë sipas standarteve dhe rregullave në fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- a) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- b) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- c) nëse nuk ka impiante sipas germës a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të

depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktojë landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe ti dokumentojë procesin.

Autoriteti Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjistrë minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore;
- b. Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg);
- d. Datën e dorëzimit;
- e. Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim;

Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë bashkë me faturen tatimore mujore të shërbimit të realizuar dhe fletën e depozitimit të produktit final, që del nga asgjësimi/trajtimi, në një landfill të licensuar, sipas kuadrit rregullator në RSH.

Argumentimi: Keto specifikime teknike u vendosën në mbështetje të Shkresës nr.902/1 prot., datë 14.08.2025 “Kërkesë” të Sektorit të mjedisit, si dhe shkresën nr. 966/2 Prot., datë 01.09.2025, “Proces-verbal mbi hartimin e kërkesave të vecanta për kualifikim” të specialistit të fushës si dhe në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrimi i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzimi i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”

TERMAT E REFERENCES

OBJEKTI DHE QËLLIMI I SHËRBIMEVE:

Objekti: “Evadim, Trajtim dhe Asgjësim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore në Spitalin Rajonal Lezhe” e ndare në 3 (tre) lote - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj)”

Qëllimi i shërbimit:

Realizimi i proceseve të grumbullimit, transportit, magazinimit të përkohshëm, trajtimit të mbetjeve spitalore si dhe evadimit për asgjësim të tepërive që rezultojnë nga trajtimi, me qëllim që i gjithë procesi i menaxhimit të mbetjeve spitalore të sigurojë zvogëlimin e rrezikshmërisë së tyre dhe optimizimin e grumbullimit, transportit dhe trajtimit të tyre deri në evadimin përfundimtar me asgjësim të tepërive.

DETYRAT:

Operatori Ekonomik fitues duhet të realizojë shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve spitalore, sipas kontratave përkatëse të shërbimit që do të lidhen nga AK.

Elementët përbërës të shërbimit dhe detyrat specifike që duhet të kryhen nga Operatori Ekonomik fitues (Kontraktori), janë si vijon:

1. Sigurimi për Autoritetin Kontraktor i bazës materiale për Mbetjet Spitalore

Kontraktori do të jetë përgjegjës, që gjatë të gjithë periudhës së shërbimit, brenda vlerës së shërbimit të kontraktuar dhe sipas nevojës së AK, të furnizojë AK me bazën materiale të nevojshme që do të përdoren nga AK për amballazhimin etiketimin dhe grumbullimin e vecantë dhe e mbetjeve spitalore të prodhuara sipas rrymave përkatëse.

Grumbullimi i vecantë është ndarja në burim nga vetë AK e mbetjeve spitalore të rrezikshme nga ato të parrezikshme, dhe të mbetjeve të rrezikshme në rryma të vecanta sipas kodeve të paragrafit 18, të VKM nr.402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve" (Shtojca 1). Mbetjet spitalore të parrezikshme, që në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme përzihen me mbetje spitalore të rrezikshme, trajtohen si mbetje të rrezikshme.

Baza materiale për ambalazhimin e mbetjeve spitalore duhet:

- i. Të mos lejojnë rrjedhjen, të jenë të papërshkueshme ndaj lagështirës dhe të forta për të parandaluar grisjen, çarjen apo shpimin në kushte normale përdorimi.
- ii. Të mos ripërdoren nëse janë një përdorimëshe dhe të pastrohen dhe dezinfektohen pas çdo përdorimi nëse janë disa përdorimshe apo në rast ndotje me ndonjë mbetje spitalore.
- iii. Të sigurojnë mbyllje të sigurtë, në një mënyrë që të parandalohet derdhja e mbetjeve spitalore gjatë transportit.
- iv. Të jenë të padëmtuara dhe pa ndonjë defekt tjetër që mund të çënojë përdorimin e tyre të sigurtë.

Baza materiale për ambalazhimin e mbetjeve spitalore duhet të të plotësojnë kërkesat përkatëse të përcaktuara në Specifikimet Teknike. Para magazinimit të përkohshëm nga AK në pritje të tërheqjes nga Kontraktori, kontenierët e mbetjeve spitalore të rrezikshme mbyllen dhe etiketohen sipas rrymave të vecanta. Materialet etiketuese duhet të vihen në dispozicion nga Kontraktori dhe duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara për to në Specifikimet Teknike.

Magazinimi i përkohshëm nga AK i mbetjeve spitalore të rrezikshme bëhet në një vend të caktuar, që përmbush kërkesat e posacme të përcaktuara në VKM përkatëse dhe të etiketuar posacërisht për këtë qëllim. Materialet etiketuese duhet të vihen në dispozicion nga Kontraktori dhe duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara për to në Specifikimet Teknike.

Nëse AK prodhon mbetje patologjike kodi 18 01 02, Kontraktori duhet të japë në përdorim dhe të instalojë frigorifer në ambientet e magazinimit të përkohshëm të AK me kapacitet të mjaftueshëm për nevojat e AK përkatëse dhe temperature - 18 C për ruajtjen e mbetjeve patologjike deri në momentin e marrjes në dorëzim nga Kontraktori.

2. Marrja në dorëzim dhe transportimi i Mbetjeve Spitalore

2.1 Frekuenca

Frekuenca e tërheqjes dhe marrjes në dorëzim të mbetjeve nga Kontraktori sipas rrymave përkatëse do të jetë si vijon:

Frekuenca e tërheqjes dhe marrjes në dorëzim të mbetjeve nga Kontraktori do të jetë një herë në javë.

Kontraktori në momentin e marrjes në dorëzim duhet të pranojë për transportim vetëm mbetjet spitalore që janë ambalazhuar, etiketuar me materialet e dorëzuara nga Kontraktori në përputhje me kërkesat e Specifikimeve Teknike, si dhe janë magazinuar nga AK në përputhje me kërkesat e VKM të posacme për rregullat e menaxhimit të mbetjeve spitalore.

Pas verifikimit si më sipër të plotësimit të kërkesave për ambalazhimin, etiketimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, si dhe kushtet e magazinimit nga AK, Kontraktori merr në dorëzim mbetjet spitalore për t'i transportuar në vendin e trajtimit.

2.2 Peshimi

Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që duhet të vihet në dispozicion nga ana e Kontraktorit, i cili duhet gjithashtu ta shoqërojë me certifikaten e kolaudit përkatës. Mbetjet e destinuara për tu dorëzuar, do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të Kontraktorit dhe përfaqësuesit të AK dhe do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar.

2.3 Dezinfektimi

Kontenierët e mbetjeve spitalore të ripërdorshëm dhe kontenierët për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore të dezinfektohen pas çdo zbrazjeje. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Kontraktorit do të bëhet dezinfektimi i ambjentit nga ku do të tërhiqen mbetjet spitalore të magazinuar prej AK, përfshirë dezinfektimin e frigoriferit dhe ambientit përreth kur është rasti.

2.4 Marrja në dorëzim

Dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve spitalore plotësojnë dhe mbajnë nga një kopje të firmosur të Dokumentit të Dorëzimit të Mbetjeve (DDM) sipas Shtojcës 1 të VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, i ndryshuar dhe ndryshimeve ligjore që mund të ndodhin.

2.5 Transportimi

Transportimi i mbetjeve spitalore kryhet me mjete të cilat përmbushin dhe respektojnë kërkesat dhe rregullat mbi qarkullimin rrugor, kushtet higjienike, shëndetësore dhe kushtet mjedisore, sipas përcaktimeve të detajuara në Specifikimet Teknike. Mjetet e transportit të mbetjeve spitalore të rrezikshme të jenë të pajisur me **Akt-Miratimi Higjeno-Sanitar**.

Cdo automjet duhet të pastrohet dhe dizinfektohet tërësisht në pjesën e brendshme të trupit të automjetit pas çdo dite pune si dhe në rast derdhje ose ndotje me ndonjë mbetje spitalore.

Automjetet duhet të mos përdoren për qëllim tjetër përveç transportimit të mbetjeve spitalore. Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme, automjetet të mbajnë me vete veshje të mjaftueshme të sigurisë, pajisje të dekontaminimit dhe pastrimit dhe materiale për trajtimin e derdhjeve (p.sh. veshjet mbrojtëse personale, qese plastike dhe kuti të mprehtash rezervë, dezinfektues, kokrriza absorbuese, furça, fshesa leckë, lopatë dhe kova.

2.6 Trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë të kategorisë III.2.B, Leje Mjedisore dhe Akt-Miratim Higjeno-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- i. termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ii. kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- iii. mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore:

a. Teknologjitë termike pa djegie

- i. Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehjes së mbetjeve nga avulli nën presion.
- ii. Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
- iii. Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehur mbeturinat, ndërkohë mbetjet coptohen në kokrriza të thata.
- iv. Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehen nëpërmjet përcimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.

b. Teknologjitë kimike

- i. Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar

c. Teknologjitë me djegie

- i. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjegshme dhe që rezulton në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”.

D. Asgjesimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjesim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjesimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të

pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive në momentin e dorëzimit të ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër do të jete përgjegjës që të mundësojë që ky shërbim të vazhdojë sipas standarteve dhe rregullave në fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- a) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- b) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- c) nëse nuk ka impiante sipas germës a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktojnë landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe ti dokumentojë procesin.

Autoritetit Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjistër minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a) Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore
- b) Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve
- c) Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg)
- d) Datën e dorëzimit
- e) Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim

Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

E. Monitorimi

Autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të kontratës së lidhur me OE fitues është përgjegjës për plotësimin e kërkesave për procesin e përzgjedhjes së subjektit të licensuar dhe për monitorimin e respektimit të detyrimeve nga OE. Për këtë, subjekti i licensuar i kontraktuar detyrohet t'i dorëzojë prodhuesit të mbetjeve, nëse është e mundur në çdo marrje në dorëzim pasardhëse të mbetjeve spitalore, por jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja në dorëzim e tyre, dokumentacionin për realizimin e proceseve të menaxhimit të mbetjeve spitalore të kontraktuara.

F. Sasia sipas kodeve për periudhën 24 mujore, duke u bazuar në mesataren vjetor të mbetjeve.

Argumentimi: Sasia dhe termat e references u vendosen ne mbeshtetje te Shkreses nr.902/1 prot., datë 14.08.2025 “Kërkesë” të Sektorit te mjedisit, si dhe shkresën nr. 966/2 Prot., datë 01.09.2025, “Proces-verbal mbi hartimin e kerkesave te vecanta per kualifikim” të specialistit të fushës si dhe në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :
15.09.2025 ora 09:00.**

NJËSIA E PROKURIMIT